



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 147, Datë 04.10.2019**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
"FURNIZUESI I SHERBIMIT UNIVERSAL (FSHU)" SH.A NË VEPRIMTARINË E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2 gërma "ç" të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma "d", nenit 5, pika 1, germa "d", nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma "a" të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e datës 04.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr.92/2 Prot, datë 30.09.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)" sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria "OSHEE" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 519 Prot, datë 27.08.2019, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për Sektorin e Enrgjisë Elektrike", i ndryshuar; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe Urdhërit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 157 Prot., datë 12.02.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a në cilësinë e Aksionarit themelues,në datë 28.03.2018 është themeluar Shoqëria "Furnizuesi i Sherbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a), për kryerjen e aktivitetit të furnizimit
- ERE më vendimin nr. 215, datë 11.10.2018, transferoi licencën e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251 me Seria P14FPP miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e

bordit të ERE-s nr. 112, datë 08.07.2016 tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a. (FSHU sh.a.).

- Pas konstatimit se ky aplikim është kryer nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a. dhe jo nga shoqëria e krijuar për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a) ERE me shkresën nr. 519/1 Prot., datë 12.09.2019, i'u drejtua shoqërisë OSHEE sh.a dhe për dijeni shoqërisë FSHU sh.a, duke i bërë me dije se aplikimi për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike nr. 251, Seria P14FPP duhet të kryhet nga shoqëria FSHU sh.a.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 519/2, datë 17.09.2019 ka përcjellë aplikimin për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *"Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"* si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat "a", "b", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat "a", "b", "e" dhe "f", pika 4.7.1 gërmat "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- "Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor" neni 9, pika 2, gërma "c" (Vërtetimi i regjistrimit nga QKB), pavarësisht se nga Ekstrakti i QKB-së rezulton se shoqëria FSHU sh.a, është regjistruar në QKB në datën 30.03.2018, me NUIS L81530016L, ajo nuk ka përcjellë në ERE dokumentin "Certifikatë e Regjistrimit", do të njoftohet aplikuesi që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, t'a paraqesë në ERE, brenda afateve.
- Vërtetimet nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë të lëshuara për shoqërinë FSHU sh.a, do të kërkohet që të depozitohen në ERE në zbatim të nenit 8 pika 3 të *Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të lëshuara jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a FSHU” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**